

REPubLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 3647 Prot.

Tiranë, më 11.05.2015

UDHËZIM

Nr. 13, datë 11.05.2015

PËR
DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 11/1, DATË 15.04.2015
“PËR BOTIMIN E TEKSTEVE SHKOLLORE TË REJA
PËR VITIN SHKOLLOR 2015-2016”

Në mbështetje të neneve 45 dhe 47 të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.02.2010 “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në Udhëzimin Nr. 11/1, datë 15.04.2015 “Për botimin e teksteve shkollore të reja për vitin shkollor 2015-2016”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Germa “c” e pikës I.1 dhe germa “c” e pikës I.2, shfuqizohen.
2. Germa “a” e pikës I.2. ndryshon si më poshtë:

“a) Tekstet shkollore të reja “Matematikë 1”, “Dituri natyre 1”, “Matematikë 6”, “Fizikë 6” dhe “Biologji 6” të jenë përkthim i teksteve shkollore të shtëpive botuese “Cambridge”, “Oxford University Press” dhe “Pearson”, apo i çdo shtëpie botuese që është pjesë e tyre, duke i përshtatur sipas realiteteve shqiptare elementet që i përkasin realitetit anglez. Shtëpitë botuese konkurruese, bashkë me tekstet shkollore të mësipërme, të paraqesin edhe tekstet origjinale përkatëse dhe seritë e plota të teksteve shkollore origjinale sipas niveleve arsimore.”.

3. Pas germës “d”, të pikës I.2. shtohet germa “e” më këtë përmbajtje:

“e) Shtëpitë botuese që do të konkurrojnë për tekstin e lëndës “Edukim për shoqërinë” (Klasa 1) dhe për tekstin e lëndës “Qytetaria” (klasa 6), nuk do të përgatitin kreun për tematikën: “Prodhimi, shpërndarja dhe konsumi”. Autor për këtë tematikë do të jetë Junior Achievement si më poshtë:

Klasa 1

Lënda Edukim për shoqërinë

Tematika 3: Prodhimi, shpërndarja dhe konsumi

Tema: Familjet tona (7 orë)

Klasa 6

Lënda: Qytetari

Tematika 3: Prodhimi, shpërndarja dhe konsumi

Tema: Tregu global (8 orë).”.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit Parauniversitar dhe Komisioni i Vlerësimit të Teksteve në MAS.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren Zyrtare”.

LINDITA NIKOLLA


MINISTËR

